



Xhani De Biazi eshte ai qe pritet te dergoj Andi Lilen tek skuadra e Kievos. Bisedimet zyrtare per kete levizje kane nisur. Ne janar mbrojtessi i PAS Janines pritet te lere perfundimisht Greqine dhe te zgjedhi nje skuader te re per te vazhduar karrieren. Paraqitjet e mira tek skuadra greke dhe tek Kombetarja e Shqiperise i kane rritur vleren Liles qe tani ka shume ofreta. Nje skuader nga Japonia e ka kerkuar pak dite me pare ndersa Atalanta dhe Kievo ne Itali jane gati ta marrin. Lila ka deshire te luaj ne Itali dhe me ndermjetesimin e De Biazit transferimi tek Kievo duket i afert.